

HISTORI E SHKURTËR E ALFABETIT SHQIP



Alfabeti shqip është një version i alfabetit latin i përdorur për të shkruar gjuhën shqipe. Ai përbëhet nga 36 shkronja në total, nga të cilat shtatë janë zanore dhe 29 janë bashkëtingëllore.

1462

Alfabeti i parë shqip është shkruar nga **Pal Ëngjëlli**, Kryepeshkop i Ilirisë, i cili ka shkruar "Formulën e Pagëzimit", një dorëshkrim shqip me shkronja latine.

1496

Burimi i dytë ka qenë një fjalorth, në të cilin udhëtari **Arnold von Harff**, gjatë kalimit nëpër disa qytete bregdetare Shqiptare, shënon numërorët themelorë nga 1 deri në 1000; 8 fraza të ndryshme, si dhe 26 fjalë.

1555

Me **Mesharin e Gjon Buzukut** shpaloset një fazë e re dhe më e gjerë e alfabetit shqip. Buzuku, kryesisht përdori shkronjat e alfabetit latin.

1809

Marko Boçari shkroi fjalorin Greqisht-Shqip për konsullin Francez Pouqueville. Ky fjalor u shkrua me gërma Greke dhe u botua në vitin 1882 nga Anastas Kullurioti.

1845

Naum Veqilharxhi në veprën e tij "Libër Kendimi" më 1845 përdori një tjetër alfabet, "Ëvetarin". Ky alfabet nuk u përdor nga ndonjë tjetër dhe mbeti vetëm në zonën e Korçës.

1878

Lidhja e Prizrenit në vitin 1878 i dha rëndësi mësimi të shqipes në shkolla si e vetmja rrugë që do të çonte në krijimin e një alfabeti të përbashkët mbarë Shqiptar.

1879

Në Stamboll, **Vëllezërit Frashëri** formojnë "Shoqërinë për botime Shqipe" Kjo shoqëri krijoi një alfabet të mbështetur në shkronjat Latine dhe në disa Greke.

1899

Themelohet në Shkodër shoqëria "Bashkimi" nën kryesinë e **Imzot Preng Docit**, abat i Mirditës. Ky abat pati një mbështetje të madhe në klerin katolik dhe hartoi një Alfabet të vetin.

1908

"**Kongresi i Manastirit**" u mbajt në Manastir në nëntor 1908. Ai kurorëzoi përpjekjet e shumë brezave atdhetarësh dhe njerëzve të penës për një alfabet të gjuhës shqipe.

1908

"Kongresi

Manastirit" është ngjarja më e shënuar kombëtare në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912.

